



KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Lutfiu" Nr. 93, 10000 Prishtinë

Tel: +383 (0) 38 247-587 / +383 (0) 44 636-359

Web: www.kolegjidardania.com

Në përputhje me dispozitat e Statutit të Kolegjit "DARDANIA"- Prishtinë, 01. No. 110 – 241 e datës 10 Gusht 2010, Këshilli Drejtues i Kolegjit me 13.06.2025, e miratoi

RREGULLOREN

PËR SIGURIMIN E CILËSISË NË KOLEGJIN DARDANIA

Prishtinë,
Qershor,
2025

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Për të ruajtur cilësinë dhe për të arritur objektivat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, Kolegji Dardania ka Zyrën për Sigurimin e Cilësisë, Komisionin për Sigurimin të Cilësisë, si dhe ka krijuar sistemin e brendshëm të vetëvlerësimit të sigurimit të cilësisë;

Me këtë rregullore specifikohen mekanizmat bashkëkohore për monitorimin, vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë në Kolegj;

Rregullorja përcakton mekanizmat dhe proceset për sigurimin e cilësisë së aktiviteteve të Kolegjit që mbështeten në politikat dhe standardet të përcaktuara nga ENQA.

Sigurimi dhe Vlerësimi i Cilësisë

Neni 2

Vlerësimi bëhet për stafin akademik dhe shërbimet e Kolegjit në përgjithësi. Vlerësimet ndërmerren periodikisht nga zyrtari i Zyrës për Sigurimin e Cilësisë për të konstatuar dhe analizuar efeciencën, funksionalitetin dhe efektivitetin e shërbimeve, të stafit akademik të Kolegjit, duke përfshirë veprimtarinë kërkimore shkencore.

Vlerësimi bëhet një herë në tre vjet në rastin e akreditimit, ose një herë në pesë vjet në rastin e riakreditimeve të Kolegjit dhe njësive akademike, me përjashtim të vlerësimit të stafit akademik, kurseve lëndore dhe planeve studimore, si dhe të shërbimeve të Kolegjit vlerësimi i të cilave bëhet në fund të çdo semestri.

Neni 3

Organet e përfshira në sistemin e sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë në nivel të Kolegjit janë:

1. Senati i Kolegjit;
2. Rektori;
3. Komisioni Qendror për Sigurimin dhe Vlerësimin e Cilësisë;
4. Zyra për Sigurimin e Cilësisë;
5. Dekanet e Njësive Akademike;
6. Komisionet për Sigurimit të Cilësisë në nivel të njësive akademike.

Neni 4

Senati i Kolegjit është organi më i lartë që miraton rregulloren për sigurimin e cilësisë dhe miraton propozimin e rektorit për anëtarët e Komisionit Qendror të Cilësisë dhe Vlerësimit.

Neni 5

Rektori kujdeset që të sigurojë kushtet e përshtatshme për realizimin e veprimtarisë së vlerësimit në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë.

Rektori siguron miratimin e Bordit të Kolegjit për mbështetjen financiare të nevojshme për të kryer aktivitetin e vlerësimit të sigurimit të cilësisë në Kolegj.

Rektori siguron që rezultatet e vlerësimeve të jenë transparente në veprime konkrete operative për zbatimin e rekomandimeve me qëllim të përmirësimit të arritjes së cilësisë.

Neni 6

Komisioni Qendror për Sigurimin dhe Vlerësimin e Cilësisë në nivel Kolegji përbëhet:

- Zëvendës Rektor për mësimdhënie, ex officio;
- Zyrtar nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë;
- Njësitë akademike delegojnë nga një përfaqësues nga personeli akademik, maksimumi i të cilëve është pesë.
- Dy përfaqësues studentor;
- Një anëtar i palëve të interesuara.

Neni 7

Vlerësimi për stafin akademik, institucionin, aktivitetet arsimore e shkencore si dhe cilësinë e shërbimeve të Kolegjit realizohet sipas standardeve ndërkombëtare të vlerësimit të cilësisë.

Neni 8

Vlerësimi sipas Nenit 7 përqendrohet në:

- Monitorimin e vazhdueshëm të personelit akademik dhe administrativ, si dhe shërbimet për të vlerësuar performancën e punës në Kolegj;
- Përmirësimin e aktiviteteve arsimore, kërkimore dhe shkencore;
- Identifikimi i nevojave për zhvillim profesional;
- Motivimin e stafit për promovim, zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe shkencor;
- Konsultimin e palëve në interes për vlerësimet, opinionet, komentet dhe rekomandimet për programet dhe institucionin (studentët, ALUMNI, punëdhënësit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile);
- Planifikimin e aktiviteteve për përmirësimin dhe avancimin e veprimtarisë arsimore, punës kërkimore-shkencore dhe shërbimeve në Kolegjin Dardania si dhe përmbushjen e misionit dhe të objektivave të Kolegjit.

Neni 9

Pas vlerësimit të kryer analizohen rezultatet dhe gjetjet nga zyrtarët e Zyrës për Sigurimin e Cilësisë, dhe përmbliidhen në një raport gjithëpërfshirës. Raporti diskutohet nga Këshillat e Njësive Akadematike, Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Senati i Kolegjit, të cilët hartojnë rekomandime konkrete. Rekomandimet përfundimtare së bashku me gjetjet i dërgohen Këshillit Drejtues të cilat do të kenë ndikim në hartimin e politikave zhvillimore, caktimin e titullarit të programeve, ndarjen e buxhetit dhe përcaktimin e dinamikës së realizimit. Për të gjitha këto të gjetura njoftohet edhe themeluesi i Kolegjit.

Neni 10

Vlerësimet bëhen në këto drejtime:

- 1. Vlerësimi i ecurisë së punës studimore, kërkimore-shkencore dhe menaxheriale në të gjitha nivelet organizative në lidhje me:**
 - Zbatimi i programeve studimore të akredituara nga AKA;
 - Propozimi për ndryshimin e programeve ekzistuese dhe propozimi i programeve të reja të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës, të diplomuarve dhe të punëdhënësve;
 - Propozimi i masave organizative si përshtatja, bashkimi ose krijimi i njësive organizative;
 - Plotësimi i nevojave dhe synimeve në aspektin social, ekonomik dhe kulturor.
2. Vlerësimin e ecurisë së studimeve dhe suksesit të angazhimit të studentëve në studime;
3. Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies;
4. Vlerësimin e performancës së pedagogëve dhe asistentëve;
5. Vlerësimin e veprimtarive kërkimore sipas fushave shkencore.

Vlerësimet bëhen për të konstatuar nivelin e përmbushjes së objektivave, plotësimin e obligimeve në punë, cilësinë e përgatitjes të stafit akademik dhe jo akademik, propozimit të masave për përmirësimin e cilësisë të institucionit respektivisht të programeve studimore dhe të shërbimeve administrative me qëllim të përditësimit të planit strategjik.

Vlerësimi i punës së pedagogëve, kërkimi shkencor

Neni 11

Vlerësimi i punës të stafit akademik në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor bëhet në këtë mënyrë:

1. **Vlerësimi i brendshëm** bëhet nga Komisioni për Sigurimin e Cilësisë sipas dinamikës së parashikuar dhe përfshin:

- Vëzhgimi kolegjial;
- Vetëvlerësimin e stafit akademik përmes pyetësorëve;
- Vlerësimin e stafit akademik (mësimdhënës dhe asistentë) nga studentët përmes pyetësorëve anonim;
- Monitorimi nga kolegët, respektivisht ekspertët e angazhuar nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë së Kolegjit.

Kolegji kryen rregullisht vlerësime të brendshme në përputhje me dispozitat e Statutit të Kolegjit dhe kësaj Rregulloreje.

2. **Vlerësimi i jashtëm** realizohet nga ekspertët e AKA-së në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-037, Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë 15/18, si dhe Manualin e Akreditimit të AKA-së. AKA organizon procedurat pas akredituese si dhe procedurat e monitorimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

- Vlerësimi i shërbimeve dhe stafit në institucion;
- Monitorimi i dokumentacionit;
- Raportet e vlerësimit nga ekspertët.

AKA dhe MASHT zbatojnë vlerësimin e jashtëm në përputhje me dokumentet e mësipërme.

Neni 12

Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga studentët bëhet dy herë në vit (në fund të çdo semestri) përmes pyetësorëve anonimë të përpiluar nga zyrtarët e Zyrës për Sigurimin e Cilësisë.

Pyetësorët përpilohen për çdo njësi akademike, bazuar në strukturën standarde në versionin elektronik dhe të printuar të cilët përditësohen në mënyrë ciklike.

Pyetësorët përpunohen në mënyrë elektronike nga zyrtarët e Zyrës për Sigurimin e Cilësisë mbi bazën e të cilave përpilohet raporti për lëndët dhe njësitë e përfshira në vlerësim. Pyetësorët ruhen në Zyrën për Sigurimin e Cilësisë në version elektronik dhe të printuar.

Neni 13

Të gjitha vlerësimet e jashtme dhe të brendshme do të kryhen me procedurë standarde, duke përfshirë veprimet e mëposhtme:

1. Njësitë akademike të Kolegjit informohen paraprakisht për procesin dhe aspektet e vlerësimit:

- Fushat;
- b) Objektivat;
- c) Procedurën;
- d) Oraret;
- e) Instrumentet.

2. Zyrtarët e Zyrës për Sigurimin e Cilësisë hartojnë raportin me shkrim i cili përmban këto zhvillime:

- Procedura e vlerësimit;
- Rezultatet;
- Masat e propozuara në lidhje me gjetjet.

3. Raporti preliminar i'u dërgohet njësive të vlerësuara së bashku me gjetjet dhe masat e propozuara për përmirësim të cilësisë. Njësitë akademike të përfshira në vlerësim, zhvillojnë diskutime për pikat e forta dhe pikat e dobëta, të konstatuara në raport. Njësive akademike u jepet një periudhë e arsyeshme kohore për të paraqitur arsyetimet për gjetjet dhe për të dhënë komente për aspekte të veçanta të raportit. Komentet analizohen dhe diskutohen së bashku dhe të njëjtat pas marrëveshjes reciproke bëhen pjesë integrale e raportit përfundimtar të vlerësimit.

Rektori, prorektori dhe dekanët e njësive akademike analizojnë vlerësimin e veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore, diskutojnë raportin në nivel institucional dhe propozojnë masat e duhura për përmirësim të mëtejshme. Në raste të tilla Këshilli Drejtues miraton propozimet për rishikimin e prioriteteve, me rastin e përditësimit të Planit Strategjik. Raporti përfundimtar shërben si mjet për rishikimin dhe përshtatjen e planit zhvillimor të Kolegjit Dardania në përputhje me zhvillimet bashkëkohore në zonën evropiane të arsimit të lartë dhe në përputhje me standardet e ENQA.

4. Raporti përfundimtar i vlerësimit i dorëzohet:

- a) Njësive akademike të përfshira në vlerësim;
- b) Zyrtarëve të njësive akademike përgjegjëse për njësitë e vlerësuara;
- c) Zyrtarëve të Rektoratit;
- d) Themeluesit;
- e) Këshillit Drejtues, i cili është përgjegjës për hartimin e planit strategjik në të cilin përfshihen aktivitetet për masat e propozuara për përmirësimin e cilësisë sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje.

5. Raportet përfundimtare të vlerësimit të brendshëm (institucionit, stafit akademik, ALUMNI dhe punëdhënësve), të përmbledhura publikohen në tabelën e shpalljeve dhe në website-in e Kolegjit Dardania.

Vlerësimi i jashtëm

Neni 14

Vlerësimi i jashtëm bëhet:

- a) Sipas planit të veprimit të AAK-së;
- b) Sipas dinamikës së punës së MASHT-it;
- c) Me kërkesë të Bordit Drejtues, përkatësisht Rektorit të Kolegjit, me ose pa njoftim paraprak.

Neni 15

Njësitë e Kolegjit dhe organet e tyre drejtuese janë të obliguara të bashkëpunojnë me Zyrtarët e Zyrës për Sigurimin e Cilësisë, duke ofruar informacione të nevojshme përkitazi me vlerësimin.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 16

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i Kolegjit Dardania.

Kryetari i Senatit të Kolegjit Dardania

Prof. Dr. Gjyldane Mulla

